



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c) lidhur me nenin 17, pikat (k, r dhe s) të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Rregulloren MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 41, paragrafi 2, pika (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, merr vendim dhe shpallë:

Datë: 12.03.2024

THIRRJE PUBLIKE

- **Për financimin e projekteve të personave juridik - OJQ-ve, në vlerë mbi 500.00€, nga fusha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kriteret më poshtë:**

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjithë personave juridik - OJQ-ve, të regjistruara dhe që veprojnë në Republikën e Kosovës, bazuar në programin e punës i cili është i fokusuar në realizimin e aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.
2. Personat juridik - OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

Kulturë:

- Teatër
- Muzikë/Koncert,
- Arte vizuele,
- Diversitet kulturor
- Murale
- Aktivitete letrare

Rini:

- Inovacion (animacion, IT, dixhitalizim, marketing dixhital)
- Shëndet publik
- Çështje sociale
- Sport dhe rekreacion
- Ambient, planifikim hapësinor dhe zhvillim rural

Sport:

- Aktivitete sportive;
- Pjesëmarrja e klubeve sportive në gara kampionale dhe për kupën e Republikës së Kosovës të organizuar nga Federatat përkatëse;
- Pjesëmarrja nëpër turne të ndryshme në vend dhe regjion:
- Organizimi i turneve me rastin e festave shtetërore dhe kombëtare;
- Organizimi i turneve me rastin e shënimit të datave përkujtimore.

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është: 90'000.00 Euro

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 500,00 Euro, ndërsa shuma maksimale 10'000.00 Euro.

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë kalendarike dhe përfundon me datën: 26.03.2024

5. Personat juridik - OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje publike. Periudha e zbatimit të projektit është brenda vitit kalendarik 2024.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë Personat juridik - OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo - qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Vushtrri, të cilat aplikojnë me projekt/program me interes për Komunën e Vushtrrisë.

Personat juridik - OJQ-të duhet të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ - të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Para nënshkrimit të kontratës, Personat juridik – OJQ duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit dhe përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se personat juridik OJQ - të kanë zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me **Udhëzimet për Aplikantët**, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare www.kk.rks-gov.net/vushtrri/.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht në zarf të mbyllur, duke specifikuar mbi zarf Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Vushtrrisë

Rr."Adem Jashari"

(zyra e pranimit)

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues të zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Për mbështetje financiare do të merren parasysh vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

7. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: shukrane.begu@rks-gov.net

Medina Bunjaku

Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport